



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**VENDIM**

Nr.145, datë 18.07.2024

**PËR**

**“FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT SË PASURISË DHE FIGURËS PËR KANDIDATIN QË KA KANDIDUAR PËR RIEMËRIM NË POZICIONIN E DREJTUESIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË, DHE CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR KËTË PROCEDURË, PËR ZOTIN ERJON SHEHAJ”**

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “a” të Kushtetutës, nenet 159, pika 2, 161 dhe 190, pika 2, të ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, pikat 2-7 të nenit 32 dhe nenin 52 të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe në relacionin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për riemërim në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, zoti Erjon Shehaj.
2. Caktimin me short të relatorit Tartar Bazaj për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për riemërim në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, zotit Erjon Shehaj.
3. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe Njësia e Mbështetjes së Komisioneve për ndjekjen e këtij procesi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 18.07.2024.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**



**ANËTAR**  
**Sokol Stojani**

**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**  
**Vatë Staka**

**ANËTAR**  
**Ledina Riza**

**ANËTAR**  
**Olger Eminaj**

**ANËTAR**  
**Moisi Duda**

